



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|   |                               |                               |                               |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Prijmljeno/Prodato<br>Received/Delivery | 29.06.2023                    | viti<br>god<br>year           | 3                             |
| Organ./Njësia<br>Organ./Jedinica<br>Org./Unit                 | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SHQYRTIM  | 4961/2023                     |                               | 1/4                           |



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.750/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.750/2023 të datës 17.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kundërshtim i masës disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.06.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.750/2023 e datës 17.05.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet masa disiplinore "Vërejtje" e shqiptuar ndaj ankuesit nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit përmes shkresës me numër protokollit 490/23 të datës 08.05.2023.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësit civil si dhe regjistri përkatës masën disiplinore e anuluar si në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi ( *tutje vetëm ankuesi*), i punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, më datë 17.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtje" të shqiptuar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit, përmes shkresës me numër 490/23 të datës 08.05.2022, me pretendimin së masa

disiplinore e kundërshtuar është shqiptuar duke u mbështetur në supozim, dhe pa dëshmi konkrete të ndonjë lëshimi apo mangësie procedurale e as në argumente që pushimi i zyrtareve ka ndikuar në ngecje të punëve të institucionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës (*me tej referuar Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Organi Shqyrtues të Prokurimit, ndërsa ky i fundit me datë 29.05.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat ndërlidhur me

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4314/2023 të datës 17.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Masën Disiplinorë Vërejtje e datës 08.05.2023 e shqiptuar përmes shkresës me numër 490/23 nga kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit; Vendimin për pushim prej datës 02.05.2023 deri më datë 08.05.2023 sipas kërkesës së datës 25.04.2023; Vendimin për pushim prej datës 02.05.2023 deri më datë 08.05.2023 sipas kërkesës së datës 24.04.2023; Vendimin për pushim prej datës 02.05.2023 deri më datë 08.05.2023 sipas kërkesës së datës 24.04.2023; Vendimin për pushim prej datës 24.04.2023 deri më datë 12.05.2023 sipas kërkesës së datës 05.04.2023; E-mailin zyrtar i datës 11.05.2023 nga ankuesi për Kryetaren e OSHP-s me titull Kërkesë për anulimin e e vërejtjes të datës 08.05.2023 me nr.490/23; Vendimin me numër protokolli 440/23 të datës 27.04.2023 mbi lejimin e udhëtimit zyrtar; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 29.05.2023; Akt emërimit Nr.97/2013 të datës 05.02.2013 dhe E-mail zyrtar i datës 22.06.2023 nga Udhëheqësja e BNj të OSHP-së sipas kërkesës së Këshillit përmes emailit të datës 22.06.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së pretendimet ankimore të ankuesit janë të **bazuara, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe se i njëjti sipas Aktit të Emërimit me nr.97/2013 të datës 05.02.2013, ushtron pozitën e punës më titull *Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së*.

Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit më datë 08.05.2023 përmes shkresës me numër protokolli 490/23, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetim së i njëjti ka lejuar miratimin e pushimeve vjetore të katër zyrtarëve të OSHP -së në të njëjtën kohë pa u konsultuar paraprakisht me Bordin e OSHP-së si dhe pa analizuar ngarkesën në punë, duke shkaktuar ngecje të konsiderueshme në realizmin e detyrave dhe ngarkesa të shtuara dhe të papërbalueshme.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon së masa disiplinore e kundërshtuar është shqiptuar duke u mbështetur në supozime, dhe pa dëshmi konkrete të ndonjë lëshimi apo mangësie procedurale e as në argumente që pushimi i zyrtareve ka ndikuar në ngecje të punëve të institucionit. Propozon që Këshillit të aprovoj aneksen si të bazuar dhe të anuloh masën disiplinore Vërejtje të datës 08.05.2023.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së masës disiplinore të kundërshtuar më ankesë Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar procedurës disiplinore të nëpunësve civilë përkatësisht nenin 45 më të cilin përcaktohet se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore dergjët veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", dhe si rrjedhojë ka konstatuar së nëpunësi civil mbanë përgjegjësi disiplinore në rastet kur vërtetohet se i njëjti më me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur dispozitat e ligjit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës për pozitën që mbanë, dhe mbi bazën që të jenë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht, edhe organ kompetent në realizimin e autoritetit publik gjegjësisht me rastin e vendosjes lidhur me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të nëpunësve civil janë të obliguar që të veprojnë në pajtueshmëri me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë, mosdiskriminimit, objektivitetit, paanësisë, pritshmërisë së ligjshëm dhe të arsyeshme, si dhe parimit të informimit dhe ndihmës aktive siç është përcaktuar me nenin 4, 5, 6, 7, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu, Kolegji për vendosje të drejtë të kësaj çështje juridiko-administrative mori parasysh edhe dispozitat e nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilat janë përcaktuar në mënyrë shprehimore shkeljet disiplinore, ku parashihet se: *Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.*

Rrjedhimisht, në kuptim të kuadrit ligjor si me sipër si dhe bazuar në vlerësimin e provave të lëndës, Kolegji i Këshillit vlerëson së Kryetarja e Bordit të OSHP-së më rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankuesit nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, duke e shpallur përgjegjës ankuesin për shkeljeje të lehtë disiplinore, sepse, sipas provave material rezulton se Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave ka katër (4) zyrtarë të nivelit profesional 1, me ç'rast vetëm dy prej tyre iu është aprovuar pushimi vjetor, ndërsa dy nga zyrtaret tjerë kanë qenë në punë, rrjedhimisht për periudhën kontestues në pushim vjetor kanë qenë Asistentja Ekzekutive për periudhën nga data 02.05. deri 08.05.2023,

përkthyesja anglisht-shqip për periudhën nga data 02.05 deri 08.05.2023, Ekspertja Shqyrtuese për periudhën nga 02.05 deri 05.05.2023 i dhe eksperti shqyrtues për periudhën nga data 24.04.2023 deri me 12.05.2023.

Me tej, Kolegji si rrethana relevante për vendosje konsideroj edhe faktet së pushimet e zyrtarëve janë miratuar nga mbikëqyrësit e tyre që mbajnë përgjegjësi të koordinimit të punëve në kuadër të njësisë që menaxhojnë përfshirë edhe pushimet e punëtorëve dhe së i tërë Bordi i OSHP-së nga data 03.05.2023 deri 06.05.2023 (pa data të udhëtimit) ka qenë në udhëtim zyrtar jashtë vendit, periudhë që përkon me periudhën e pushimeve vjetore të zyrtarëve. Rrjedhimisht nga data 03-05 deri 06.05.2023 nuk ka pas ndonjë aktivitet të Bordit, kështu që në vlerësimin e Kolegjit për këtë periudhë kohore ka qenë e pa nevojshme mbështetja administrative e Bordit nga stafi profesional, duke nënkuptuar edhe faktin së mungesa e zyrtarëve për shkak të pushimit vjetor nuk ka ndikuar në mos funksionalizmin e punëve të Bordit dhe se pushimi i tyre mund të konsiderohet i koordinuar.

Për me tepër, Kolegji nga analizimi i masës disiplinore të kundërshtuar më ankesë vlerëson së Kryetarja e Bordit të OSHP-së ka dhënë konstatim të përgjithshme lidhur me ngecjet dhe ngarkesën në punë, duke mos arritur të argumentoj saktë dhe në mënyrë specifike cilat kanë qenë ngecjet në realizimin e detyrave të këtij institucioni, cilat aktivitete të shtuara nuk kanë mundur të realizohen dhe cili ka qenë dëmi që institucioni ka pësuar nga pushimi i zyrtarëve në fjalë, andaj në mungesë të këtyre fakteve Kolegji nuk ka mundur të vërtetoj se ankuesi është përgjegjës lidhur me shkeljet disiplinore sikurse është përcaktuar në shkresën me numër protokolli 490/23 të datës 08.05.2023, më të cilën ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Vërejtje".

Andaj, mbi bazën e rrethanave dhe konstatimeve si me lart, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.750/2023

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

*Ardita Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.